REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M
Nr.25. Datë.03/09/2025

PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË MARREVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË DHE UNIVERSITETIT FAN S.NOLI PËR PROJEKTIN "UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL"

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Vendimi Nr. 51 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025", Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar, VKM-së nr. 692, datë 05.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", Urdheri nr. 258, datë 15.7.2024 "Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre";

V E N D O S I:

1. Të miratojë marrëveshjen midis Këshillit të Qarkut Korçë dhe Universitetit Fan S.Noli për projektin "Udhërrëfyes Turistik Lokal".
2. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Korçë që të lidhë marrëveshjen e bashkëpunimit midis Këshillit të Qarkut Korçë dhe Universitetit Fan S.Noli, për projektin "Udhërrëfyes Turistik Lokal".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori Juridik, burimeve njerëzore dhe shërbimeve, Sektori i projekteve të zhvillimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI
Erjon Nexhipi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Miratuar me	**17 / Vota**
Vota Pro	**17 / Vota**
Vota Kundër	**0 / Vota**
Vota Abstenim	**0 / Vota**
Zbardhur më datë	**03/09/2025**

Koncept: *M. Bylykbashi*
Sekretari: *B. Muco*

7/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr_____ Prot. Korçë, më__ .09.2025

RELACION

"PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË MARREVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË DHE UNIVERSITETIT FAN S.NOLI PËR PROJEKTIN "UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL"

I. QËLLIMI I P/VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij P/Vendimi është miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis:

UNIVERSITETIT FAN S.NOLI

DHE

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Në kuadër të zbatimit të projektit: Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Vendimi Nr. 51 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025", Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar, VKM-së nr. 692, datë 05.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", Urdheri nr. 258, datë 15.7.2024 "Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre";

Projekti **"UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL"** ka si qëllim te rrise kohezionin social permes standartizimit dhe diversifikimit te sherbimeve turistike te licensuara "Udherrefyes Turistik" duke ofruar mundesi te barabarta, nxitje te vet punesimit, ngritjes së një sistemi të formimit të vazhdueshëm profesional per te rinjte, si dhe promovimi i pasurive natyrore, historike e kulturore I rajonit permes tyre. Projekti është një metodologji për zhvillimin dhe tërheqjen e investimeve në ekonominë lokale rajonale duke u bazuar në strategjine e udherrefyesit turistik lokal si nje qasje inovatore turistike rajonale.

Marrëveshja konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për realizimin e projektit **"UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL".** Ky projekt ka si qëllim te rrise kohezionin social perms standartizimit dhe diversifikimit te sherbimeve turistike te licensuara "Udherrefyes Turistik" duke ofruar mundesi te barabarta, nxitje te vet punesimit, ngritjes së një sistemi të formimit të vazhdueshëm profesional per te rinjte, si dhe promovimi i pasurive natyrore, historike e kulturore lokale dhe rajonale.

UNIVERSITETI "FAN S NOLI"

- Universiteti "Fan S Noli" ka për detyrë të krijojë të gjitha kushtet e nevojshme në mënyrë që të realizohet qëllimi i projektit **"UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL"**.
- Universiteti "Fan S Noli" ka për detyrë që shumën e financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë ta përdorë vetëm për realizimin e projektit **"UDHËRRËFYES TURISTIK LOKAL".**
- Universiteti "Fan S Noli" ka për detyrë të vendosi në dispozicion stafin akademik të kualifikuar si dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin e projektit.
- Universiteti "Fan S Noli" ka për detyrë që të ndjekë dhe monitorojë në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë vijueshmërinë e këtij projekti deri në gjenerimin e certifikimit final të udhërrëfyesve nga institucionet përgjegjëse.

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

- Këshilli i Qarkut Korçë, ka për detyrë të japë kontributin e tij financiar për tarifën e plotë të programit referuar vendimit nr. 325, datë 29.05.2025 të Senatit Akademik të Universitetit Fan S.Noli "Për miratimin e tarifave dhe mënyrën e pagesës së stafit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal" :
  - 1600 lekë personi tarifë regjistrimi në program;
  - 32000 lekë personi tarifë e plotë e programit.

  Shuma totale 672,000 lekë (për 20 persona) detyrim për tja kaluar këtë vlerë Universitetit Fan S.Noli.
- Këshilli i Qarkut Korçë ka për detyrë që të ndjekë dhe monitorojë në bashkëpunim me Universitetin "Fan S Noli" vijueshmërinë e këtij projekti deri në gjenerimin e certifikimit final të udhërrëfyesve nga institucionet përgjegjëse.

Projekti synon te edukojë guida të udhëhequra nga empatia, ndjeshmëria e thellë ndaj traditës, kulturës dhe vlerave natyrore, edukimi i mbrojtjes së natyrës, mjedisit dhe qytetarëve që minimizojnë efektet negative të turizmit, duke synuar njohjen e thellë të identitetit lokal, guximi i mendimit kritik ndaj zhvillimeve me pasoja në asetet e turizmit.

Pjesemarresit do te marrin trajnim te thelluar ne fushat e udhezimit turistik duke perfshire njohurite mbi historine lokale, kulturen, gjeografine, arkeologjine si dhe atraksionet turistike te rajonit. Udhërrëfyesi Turistik lokal do të jete imazhi i destinacionit, promovues dhe theksues i vlerave të mira që e çojnë klientin drejt përvojave dhe emocioneve te patjetersueshme rajonale.

KABINETI I KRYETARIT

Këshilltari Juridik

Marjona Bylykbashi